



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
PRIVREDNI SUD - COMMERCIAL COURT



**Raporti i Punës së
Gjykatës Komerciale
për vitin 2023**

Tabela e përmbajtjes

I. Hyrje.....	3
II. Aktivitetet dhe të arriturat e Gjykatës Komerciale gjatë vitit 2023.....	5
III. Plani i Veprimit për Reduktimin e Lëndëve – maj – dhjetor 2023.....	5
IV. Organizimi i punës në Gjykatën Komerciale	6
2.2. Zyra e Kryetarit	6
2.3. Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve dhe Divizioneve.....	7
2.3.1. Raportimi i punëve të gjyqtarëve të dhomave të shkallës së dytë	8
2.3.2. Raportimi i punëve të gjyqtarëve të dhomave të shkallës së parë	8
2.3.3.1. Departamenti për Çështje Ekonomike.....	8
2.3.3.2. Departamenti për Çështje Administrative	9
2.3.3.3. Departamenti i Përgjithshëm	9
2.3.3.4. Departamenti Fiskal	9
2.4. Raportimi i monitorimit për zbatimin e normës së punës së gjyqtareve.....	10
2.5. Aktivitetet dhe veprimet tjera	12
2.5.1. Unifikimi i praktikës gjyqësore.....	12
2.5.2. Përmirësimi i infrastrukturës dhe hapësirave të Gjykatës	12
2.5.3. Zbatimi i Programit TIK/SMIL.....	12
2.5.4. Mbledhjet e kolegjiut të të gjithë gjyqtarëve.....	12
2.5.5. Pjesëmarrja në trajnime.....	13
2.5.6. Pjesëmarrja në punëtori dhe aktivitete tjera	13
2.6. Aktivitetet dhe të arriturat e Njësisë Ligjore	13
2.7. Aktivitetet dhe të arriturat e Administratës	14
2.8. Aktivitetet e Zyrës për Komunikim.....	14
2.7.1. Mbajtja e shqyrtimeve gjyqësore	15
III. Vendosja dhe fuqizimi i bashkëpunimeve gjatë vitit 2023	15
V. Raportimi financiar dhe logjistika	15
VI. Përfundimi	0

I. Hyrje

Bazuar në dispozitën e nenit 16 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, dhe konform nenit 14 paragrafi 2 pika 2.4 të Ligjit për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës Komerciale, paraqet raportin e punës për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2023 të Gjykatës Komerciale të Kosovës, përkatësisht Dhomave të Shkallës së Dytë, Dhomave të Shkallës së Parë dhe administratës së gjykatës.

Gjykata Komerciale e Kosovës më 22 dhjetor 2022 ka hartuar planin e punës së gjykatës për vitin 2023, i cili plan kishte për qëllim organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës, ndarjen, përgjegjësitë dhe kompetencat e departamenteve, caktimin e gjyqtarëve në departamentet përkatëse si dhe udhëheqësit e departamenteve, përbërjen e kolegeve të Dhomave të Shkallës së Dytë, adresimin sa më efikas dhe në funksion të trajtimit dhe zgjidhjes sa më të shpejt të çështjeve gjyqësore etj .

Bazuar në rezultatet e punës për këtë periudhë, vlerësoj se plani vjetor i gjykatës së vitit 2023, është zbatuar edhe përkundër faktit se gjykata ka funksionuar me kapacitete jo të plota, për shkak të mos plotësimit të numrit të gjyqtarëve, stafit administrativ dhe profesional, siç përcaktohet edhe me organogramin e Gjykatës Komerciale, por edhe mos plotësimit të kushteve me hapësira të mjaftueshme, megjithatë edhe me kapacitetet ekzistuese është arrit performancë në zgjidhjen e lëndëve.

Gjykata Komerciale e Kosovës, procesin profesional të punës, gjatë periudhës raportuese e ka kryer me shtatëmbëdhjetë (17) gjyqtar, gjashtë (6) gjyqtar janë caktuar në Dhomat e Shkallës së Dytë dhe njëmbëdhjetë (11) gjyqtar janë caktuar të gjykojnë në Dhomat e Shkallës së Parë, në fund të vitit raportues është hapur edhe konkursi i brendshëm për plotësimin e dy pozitave të lira për gjyqtar. Gjatë kësaj periudhe pesë nga gjyqtarët e Shkallës së Parë pavarësisht emërimit të tyre, nuk kanë vepruar me kapacitetin e tyre të plotë për shkak se kanë qenë gjyqtarë të rinj të cilët kanë ndjekur trajnimin fillestar dhe kanë qenë të angazhuar vetëm pjesërisht dhe atë në lëndët përmbartimore. *(dy gjyqtarë janë emëruar në muajin mars 2023, ndërsa dy të tjerë në muajin qershor 2023. Ndërsa një gjyqtare ka qenë në Programin Master dhe ka filluar punën me 1 korrik 2023.)*

Numri aktual i gjyqtarëve të caktuar në Gjykatën Komerciale, është i pamjaftueshëm dhe në shpërputhje me Ligjin për Gjykatën Komerciale sipas të cilit minimumi i gjyqtarëve duhet të jetë 20, dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin dhe efektivitetin e Gjykatës dhe pamundëson arritjen e objektivave, duke marrë parasysh kompetencat që i ka kjo gjykatë dhe numrin e madh të lëndëve të pranuar, andaj është e rëndësishë së veçantë që të shtohen kapacitetet në mënyrë që të lehtësohet menaxhimi me ngarkesën me lëndë.

Përveç numrit të vogël të gjyqtarëve të angazhuar, gjykata po ashtu deri në fund të këtij viti raportues ka funksionuar me kapacitete të përgjysmuara edhe në aspektin e plotësimit të të gjitha pozitave administrative të cilat parashihen me organogramin e Gjykatës Komerciale. Ndërsa në fund të vitit gjykata ka pranuar pesë (5) bashkëpunëtor profesional dhe trembëdhjetë (13) zyrtar ligjor. Megjithatë presim që SKGjK, sa më shpejtë të filloj me procedurën e rekrutimit për plotësimin e të gjitha pozitave të lira me qëllim që edhe trajtimi i lëndëve të bëhet në përputhje me afatet ligjore, dhe sipas kësaj do të krijohet edhe siguri juridike, njëkohësisht edhe rritje e besueshmërisë së publikut në sistemin e drejtësisë .

II. Aktivitetet dhe të arriturat e Gjykatës Komerciale gjatë vitit 2023

Përmes këtij raporti vjetor të punës së gjykatës për vitin 2023 në vijim, do të paraqiten në mënyrë të detajuar raportet statistikore; të arriturat; sfidat me të cilat është ballafaquar gjykata gjatë vitit 2023, si dhe përmbledhje e punëve administrative të gjykatës gjatë kësaj periudhe raportuese.

III. Plani i Veprimit për Reduktimin e Lëndëve – maj – dhjetor 2023

Pranimi i qindra çështjeve gjyqësore të pazgjidhura nga Gjykatat Themelore të Kosovës dhe ajo e Apelit, dhe lëndët e reja të pranuar, përkundër numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe stafit administrativ dhe profesional, është treguesi më i mirë për përkushtimin dhe angazhimin e stafit të gjykatës për avancimin kuptimplotë në shkurtimin e kohës së procedimit të çështjeve gjyqësore të të gjitha lëmime, eliminimin substancial të lëndëve të vjetra, atyre të kthyera në rigjykim, e gjithë kjo me qëllim të ndërtimit të imazhit të një institucioni të respektuar, të drejtë dhe profesional në shoqëri. Andaj me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në zgjidhjen e lëndëve, Gjykata Komerciale gjatë muajit prill 2023 ka hartuar Planin e Veprimit për Reduktimin e Lëndëve për periudhën maj – dhjetor 2023.

Objektivat e planit të veprimit maj – dhjetor 2023 të Gjykatës Komerciale, ishin rritja e efikasitetit, eliminimi i vonesave, ngritja e kualitetit të shërbimeve gjyqësore në veçanti e vendimeve gjyqësore, rritja e besueshmërisë dhe llogaridhënies. Plani i veprimit, vë në fokus kryesisht lëndët të cilat duhet të trajtohen me prioritet siç përcaktohet edhe me Strategjinë për Qasje në Drejtësi, përkatësisht sipas këtij plani në fokus do të jenë lëndët përmbartimore; lëndët në rigjykim dhe lëndët e vjetra.

Përmes këtij plani të veprimit si dhe në kuadër të Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi, Efikasitetin dhe Priorizimin e rasteve brenda sistemit gjyqësor, dhe me qëllim të ofrimit të drejtësisë për të gjithë, duke promovuar sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik, gjatë periudhës maj – dhjetor 2023, ishte planifikuar që Gjykata të zgjidh rreth 5.000 lëndë, ndërsa bazuar në të dhënat statistikore për vitin 2023 kjo shifër është tejkaluar dhe janë zgjidhur 6.239 lëndë, pavarësisht që janë tejkaluar pritshmëri sa i përket lëndëve të pranuar të reja të cilat evidentohen në total 6.472.

Bazuar në planin e veprimit maj – dhjetor 2023, ishte përcaktuar që lëndë përmbartimore të zgjidhen 2.400 lëndë, ndërsa bazuar në statistikat maj-dhjetor 2023 lëndë të zgjidhura përmbartimore evidentohen 2.698 lëndë apo rreth 300 lëndë më shumë, ndërsa pritshmëria e lëndëve të reja ishte përcaktuar të jetë 720 lëndë në muaj, ndërsa lëndë të pranuar përmbartimore për periudhën prej zbatimit të Planit të Veprimit evidentohen 1.563, ndërsa lëndë të pranuar nga 1 janar deri më 31 dhjetor evidentohen 3.080.

Lëndë ekonomike bazuar në këtë planë ishte përcaktuar që me angazhimin e gjashtë (6) gjyqtarëve të zgjidhen 480 lëndë, megjithatë gjatë kësaj periudhe kanë qenë të angazhuar vetëm tre (3) gjyqtar dhe janë zgjidhur 138 lëndë. Ndërsa numri i lëndëve të reja të pranuar për periudhën janar -dhjetor është 1.088 lëndë.

Lëndë fiskale bazuar në këtë planë ishte përcaktuar të zgjidhen 400, ndërsa janë zgjidhur 156 lëndë, ndërsa lëndë të reja të pranuar evidentohen 265 lëndë.

Lëndë administrative bazuar në këtë planë ishte përcaktuar të zgjidhen 400, ndërsa janë zgjidhur 223 lëndë, ndërsa lëndë të reja të pranuar evidentohen 328 lëndë.

Lëndë të përgjithshme bazuar në këtë planë ishte përcaktuar të zgjidhen 120, ndërsa janë zgjidhur 45 lëndë, ndërsa lëndë të reja të pranuar evidentohen 67 lëndë.

IV. Organizimi i punës në Gjykatën Komerciale

Me organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës gjatë vitit 2023 ka udhëhequr Kryetari i Gjykatës, në përputhje me kompetencat ligjore punët rreth menaxhimit i janë deleguar Nënkryetares, UD Administratorit UD Udhëheqësit të Njesisë Ligjore.

2.2. Zyra e Kryetarit

Kryetari i Gjykatës, me qëllim të organizimit të punës së gjykatës dhe funksionalizimit të plotë të saj, si dhe funksionet gjyqësore të departamenteve të gjykatës, gjatë kësaj periudhe raportuese ka zhvilluar takime me gjyqtarët e gjykatës, janë mbajtur takime me udhëheqës të departamenteve të gjykatës dhe sipas nevojës janë mbajtur edhe takime të veçanta me gjyqtar, lidhur me rritjen e efikasitetit të punës së gjykatës.

Ndërsa në fund të muajit dhjetor është mbajtur edhe takimi vjetor me të gjithë gjyqtarët e gjykatës, me të cilin rast janë diskutuar raportet statistikore të gjykatës për vitin 2023, raportet individuale të gjyqtarëve, prioritetet e gjykatës për vitin 2024, si dhe është diskutuar dhe miratuar Plani Vjetor i Punës së Gjykatës Komerciale për vitin 2024.

Gjatë kësaj periudhe kryetari i gjykatës ka zhvilluar takime të shumta, me akter veprimtaria e të cilëve mund të ketë ndikim në aspektin rritjes së efikasitetit, por edhe ngritjes së besueshmërisë së opinionit publik në përgjithësi në sistemin gjyqësor. Janë zhvilluar takime të shumta me përfaqësues të projektit të USAID – Drejtësia Komerciale dhe Projekti për Drejtësi, përmes të cilit

projekt gjykata është mbështetur edhe në përgatitjen e Strategjisë së Gjykatës Komerciale për vitin 2024 – 2025; Planin Vjetor të punës.

Zyra e Kryetarit të Gjykatës Komerciale, gjatë kësaj periudhe janar – dhjetor 2023, ka përfunduar 277 vendime mbi kërkesat (*e palëve dhe gjyqtarëve*) për përjashtimin e gjyqtarëve.

Kryetari i Gjykatës Komerciale si Autoritet Kompetent për pranimin dhe shqyrtimin e ankesave disiplinore ndaj gjyqtarëve, gjatë periudhës janar – dhjetor 2023, ka pranuar dhe vendosur në tetë (8) kërkesa të inicimit të procedurave disiplinore kundër gjyqtarëve. Të gjitha këto vendime janë të publikuara në ueb portalin gjyqësor të gjykatës dhe të qasshme për publikun.

2.3. Funkcionet gjyqësore dhe udhëheqja e Departamenteve dhe Divizioneve

Në Gjykatën Komerciale gjatë vitit 2023 kanë qenë të sistemuar shtatëmbëdhjetë (17) gjyqtar. Në Dhomat e Shkallës së Dytë janë të caktuar të gjykojnë gjashtë (6) gjyqtar.

Në Dhomat e Shkallës së Parë janë të caktuar gjyqtarët si vijon:

Departamenti për Çështje Ekonomike – tre (3) gjyqtarë të cilëve i janë bashkëngjitur edhe katër gjyqtarë të rinj të cilët kanë qenë të angazhuar vetëm me lëndët përmbartimore e të cilët nuk kanë punuar gjatë tërë periudhës raportuese për shkak se kanë qenë duke e ndjekur trajnimin fillestar.

Në kuadër të Departamentit për Çështje Ekonomike funksionon *Divizioni për kontestet lidhur me Investitorët e Huaj* – në të cilin Divizion është i angazhuar një (1) gjyqtar; i cili ka qenë i angazhuar në çështjet ekonomike ndërsa kontestet lidhur me investitorët e huaj i janë deleguar si angazhim shtesë, për shkak të mungesës së mjaftueshme të gjyqtarëve dhe pamundësisë që të caktohet një gjyqtar për këto lëndë.


Departamenti për Çështje Administrative – dy (2) gjyqtar, njëri prej të cilëve është caktuar në muajin qershor;

Departamenti Fiskal – një (1) gjyqtar;

Departamenti i Përgjithshëm – një (1) gjyqtar; i cili ka qenë i deleguar në Departamentin për Çështje Ekonomike për trajtimin e lëndëve përmbartimore nga muaji shkurt 2023.

2.3.1. Raportimi i punëve të gjyqtarëve të dhomave të shkallës së dytë

Gjykata Komeriale e Kosovës përkatësisht Dhomat e Shkallës së Dytë, në periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2023, kanë ta evidentuara në punë 3.002 lëndë, prej tyre 1.272 janë lëndë të trashëguara, 1.730 janë lëndë të pranuar, 2.222 janë zgjidhur, ndërsa 780 janë të pazgjidhura. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë në Dhomat e Shkallës së Dytë është 128.44%



2.3.2. Raportimi i punëve të gjyqtarëve të dhomave të shkallës së parë

Dhomat e Shkallës së Parë, në periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2023, kanë të evidentuara në punë 12.476 lëndë, prej tyre 7.734 janë lëndë të trashëguar, lëndë të pranuar evidentohen 4.742, prej tyre 1.047 janë lëndë të pranuar në kompetencë nga Gjykatat Themelore (*lëndët e pranuar nga gjykatat themelore i përkasin viteve të para 2022, pa përfshirjen e lëndëve të pranuar të viteve 2022 dhe 2023*, janë zgjidhur 4.017 lëndë, ndërsa trashëgohen në vitin 2024 si të pa përfunduara 8.459 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë vit është 84.71 % .

2.3.3.1. Departamenti për Çështje Ekonomike

Departamenti për Çështje Ekonomike, në fillim të këtij viti raportues ka trashëguar nga viti paraparak 5.257 gjatë kësaj periudhe ka pranuar 3.341 lëndë, janë përfunduar 3.336 lëndë, ndërsa

kanë mbetur të pa përfunduara 5.262 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve në këtë departament për këtë periudhë është 99.85%.

Divizioni lidhur me Kontestet me Investitorët e Huaj gjatë kësaj periudhe raportuese ka trashëguar 10 lëndë, ndërsa lëndë të pranuar janë të evidentuara 7, të zgjidhura 2, ndërsa lëndë të papërfunduar raportohen 15.

2.3.3.2. Departamenti për Çështje Administrative


Departamenti për Çështje Administrative nga gjithsej 1.987 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre lëndë të trashëguara evidentohen 1.393 lëndë, ndërsa lëndë të pranuar gjatë kësaj periudhe janë 594 lëndë, të zgjidhura 328, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 1.659. Norma e spastrimit të lëndëve në këtë departament është 55.22 %

2.3.3.3. Departamenti i Përgjithshëm


Departamenti i Përgjithshëm nga gjithsej 158 lëndë sa ka pasur në punë, prej tyre nga viti paraprak ka trashëguar 91 lëndë, lëndë të reja të pranuar evidentohen 67, të zgjidhura 86 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 72 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve në këtë departament është 128.36%.

2.3.3.4. Departamenti Fiskal

Departamenti Fiskal, ka trashëguar nga viti paraprak 983 lëndë, ka pranuar 733 lëndë të reja, ka zgjidhur 265 lëndë, ndërsa kanë mbetur në punë si lëndë të pazgjidhura 1.451 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve në këtë departament është 36.15%



Statistikat të cilat do të paraqiten në vijim të këtij raporti në formë të grafikave pasqyrojnë, efikasitetin në kryerjen e lëndëve në Gjykatën Komerciale, duke përfshirë numrin e lëndëve të pranuar dhe të zgjidhura në Dhomat e Shkallës së Dytë dhe Shkallës së Parë.



2.4. Raportimi i monitorimit për zbatimin e normës së punës së gjyqtareve

Kryetari i Gjykatës bazuar në Rregulloren e KGJK-së nr. 03/2023 për normën e punës së gjyqtarëve, neni 22 paragrafi 1 i kësaj rregullore, paraqet në mënyrë individuale raportet e gjyqtarëve të Dhomave të Shkallës së Dytë dhe gjyqtarëve të Dhomave të Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale.

Ky raport i paraqitur në formë tabelare është një pasqyrë e monitorimit të implementimit të Normës së Punës së Gjyqtarëve për periudhën nga hyrja në fuqi e Rregullores 03/2023 deri më 31 dhjetor 2023.

DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Periudha Raportuese	TRM II	TRM III	TRM IV	Pikët në total prill - dhjetor
Saranda Bogaj Sheremeti	356	222	386	964
Faton Bajrami	325	208	421	954
Franciska Zhitija Ymeri	343	230	363	936
Krenar Berisha	373	240	293	906
Dren Rogova	281	228	302	811
Ramush Bardiqi	314	309	312	935

ZBATIMI I NORMËS SË PUNËS SË GJYQITARËVE PËR VITIN 2023

DHOMAT E SHKALLËS SË PARË

Periudha Raportuese	TM II	TM III	TM IV	Pikët në total prill - dhjetor
Verona Dibra	385	330	362	1066
Alajdin Tërshnjaku	309	220	368	898
Hasan Kryeziu	441	266	404	1113
Fisnik Nuli	330	292	322	946
Arnis Dumani	278	227	297	802
Gent Bekeri	345	254	371	971
Vlora Pacolli Rexhepi		152	278	430
Arbër Rexha	340	252	360	952
Florent Zeqiri	348	266	360	974
Vera Gashi Bala		238	306	530
Arben Toska		178	320	530

2.5. Aktivitetet dhe veprimet tjera

2.5.1. Unifikimi i praktikës gjyqësore

Gjatë vitit 2023 ka mbajtur kolegji me të rregullta mujore në të cilat është diskutuar lidhur me dilemat që shfaqen në praktikën gjyqësore dhe është tentuar të bëhet unifikimi i praktikës gjyqësore. Në këtë drejtim, kolegji i Gjykatës ka marrë qëndrime lidhur me shumë çështje që janë ngritur në kolegji dhe po ashtu lidhur me dilemat e shfaqura në konfliktet administrative, Gjykata Komerciale i është drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës për dhënien e udhëzimeve e cila ka nxjerr Udhëzues për Gjykatën Komerciale Nr. 39/2023 të datës 27 shkurt 2023.

2.5.2. Përmirësimi i infrastrukturës dhe hapësirave të Gjykatës

Gjatë vitit 2023, Gjykata ka vazhduar aktivitetin në hapësirat aktuale në Objektin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, Objekti A - kati 4-të, ndërsa për shkak të pritjes në për tu vendosur në objektin e ri, nuk ka pasur zhvillime të theksuara në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës.

2.5.3. Zbatimi i Programit TIK/SMIL

Gjykatën Komerciale, gjatë vitit 2023 nuk ka filluar së implementuari Sistemin për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (TIK/SMIL), i cili vlerësohet se ka treguar sukses dhe rritje të efikasitetit dhe transparencës së gjykatave të cilat tashmë janë duke e implementuar. Megjithatë gjatë kësaj periudhe raportuese, gjykata ka filluar futjen e të dhënave, përkatësisht regjistrimin e të gjitha lëndëve të reja të pranuar përmes SMIL, ndërsa nga fillimi i muajit janar 2024, të gjithë zyrtarët e gjykatës dhe me mbështetjen me resurse njerëzore nga Programi i USAID për Drejtësi Komerciale, do të mundësohet regjistrimi edhe i lëndëve të përfunduara, ndërsa gjatë vitit 2024, të gjitha raportet statistikore dhe të normës së gjyqtarëve do të gjenerohen vetëm përmes SMIL dhe pas regjistrimit të të gjitha lëndëve në sistem gjykata të largoj nga përdorimi regjistrat manual siç përcaktohet me Vendimin 265/2020 të KGJK-së të datë 7 dhjetor 2020, për Planin e Projektit të Sistemit të Menaxhimit Informativ të Lëndëve (SMIL), për largimin e regjistrave manual nga përdorimi në gjykata.

2.5.4. Mbledhjet e kolegjiut të të gjithë gjyqtarëve

Kryetari i Gjykatës gjatë kësaj periudhe raportuese ka zhvilluar takime të rregullta me gjyqtarët e gjykatës, janë mbajtur takime me udhëheqës të departamenteve të gjykatës dhe sipas nevojës janë mbajtur edhe takime të veçanta me gjyqtar, lidhur me rritjen e efikasitetit të punës së gjykatës.

Ndërsa në fund të muajit dhjetor është mbajtur edhe takimi vjetor me të gjithë gjyqtarët e gjykatës, me të cilin rast janë diskutuar raportet statistikore të gjykatës për vitin 2023, raportet individuale

të gjyqtarëve, prioritetet e gjykatës për vitin 2024, si dhe është diskutuar dhe miratuar Plani Vjetor i Punës së Gjykatës Komerciale për vitin 2024.

2.5.5. Pjesëmarrja në trajnime

Gjyqtarët dhe stafi mbështetës kanë ndjekur trajnimet në fushën komerciale sipas kurrikulës së Akademisë së Drejtësisë në bashkëpunim me USAID Programi për Drejtësi Komerciale, ku janë përfshirë nëntë (9) module të trajnimeve.

2.5.6. Pjesëmarrja në punëtori dhe aktivitete tjera

Gjatë periudhës raportuese, Gjykata ka qenë e përfshirë në të gjitha aktivitetet dhe punëtorit lidhur me hartimin e rregulloreve të brendshme të Gjykatës dhe dokumenteve strategjike për avancimin e punës së Gjykatës të organizuara nga KGJK dhe nga USAID Programi për Drejtësi Komerciale.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe Gjykata ka pasur një vizitë studimore në Republikën e Turqisë të organizuar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe Akademia e Drejtësisë së Turqisë.

Gjykata ka deleguar një numër të gjyqtarëve edhe në grupet punuese në fushën e hartimit të legjislacionit nga fusha komerciale.

Për pozitën udhëheqëse të Gjykatës si Kryetar, Nënkryetarja dhe Administratori, Programi i USAID-it për Drejtësi Komerciale ka zhvilluar aktivitetin e vlerësimit të nevojave të Gjykatës dhe këshilldhënies për udhëheqjen dhe menaxhimin e Gjykatës.

2.6. Aktivitetet dhe të arriturat e Njesisë Ligjore

Njësia Ligjore, gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer detyrat e saj në mbështetje të punës profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale, duke kryer hulumtime dhe analiza juridike, duke ndihmuar në hartimin e raporteve, vendimeve dhe materialeve të tjera ligjore gjyqtarët dhe gjykatën. Gjatë kësaj periudhe raportuese Njësia Ligjore ka asistuar në përpilimin e rreth 2.900 vendimeve gjyqësore përfshirë këtu edhe masat e sigurisë.

Gjatë vitit 2024, është e nevojshme që të hapet procedura e rekrutimit për Kreun e Njesisë Ligjore.

2.7. Aktivitetet dhe të arriturat e Administratës

Administrata gjyqësore e Gjykatës Komerciale, me kapacitetet aktuale më të cilat vepron është menaxhuar mbi bazën e parimeve të profesionalizmit. Administrata, gjegjësisht zyra e Administratorit të gjykatës, gjatë kësaj periudhe ka kryer me sukses aktivitetet e nevojshme rreth menaxhimit të stafit administrativ. Administrata është menaxhuar nga U.D. administratori i kësaj gjykate Ismet Musliu.

Administrata së Gjykatës Komerciale në vazhdimësi ka ndërtuar një ambient pune efikase dhe është angazhuar që të përmirësoj shërbimin ndaj palëve që përfshihen në proceset gjyqësore. Personeli i Gjykatës është menaxhuar mbi bazën e parimeve të profesionalizmit, paanshmërisë, integritetit, transparencës, përgjegjësisë dhe korrektësisë.

U.D. administratori i Gjykatës, gjatë vitit 2023, ka qenë përgjegjës për mbarëvajtjen e punës së Zyrës për Menaxhimin e Lëndëve, financat e Gjykatës, logjistikën dhe personelin deri në rekrutimin e udhëheqësve të këtyre zyrave.

2.8. Aktivitetet e Zyrës për Komunikim

Gjatë vitit 2023 publiku ka qenë i informuar rregullisht mbi punën dhe veprimtarinë e gjykatës, qoftë përmes deklarimeve për media, intervistave të ndryshme, apo përmes komunikimit zyrtar e po ashtu edhe përmes rrjeteve social.

Gjykata gjatë kësaj periudhe raportuese, ka publikuar në ueb portalin gjyqësor 4,451 vendime të Dhomës së Shkallës së Dytë dhe Shkallës së Parë,.

Përveç kësaj, Zyra për informim në vazhdimësi përmes portalit gjyqësor e po ashtu edhe rrjeteve social, ka publikuar orarin e seancave gjyqësore, njoftimet e ndryshme lidhur me punën e gjykatës apo aktivitetet e tjera, të cilat i kanë mundësuar publikut qasje më e lehtë në punën e gjykatës.

Në këtë periudhë përmes kësaj zyre janë pranuar trembëdhjetë (13) kërkesa për qasje në dokumente publike, shtatë (7) prej të cilave është lejuar qasja, në katër (4) kërkesa parashtruesi i kërkesës është njoftuar që gjykata nuk e posedon dokumentin e kërkuar dhe është udhëzuar në institucionin tjetër, dhe dy (2) kërkesa, janë tërhequr nga kërkesa për qasje.

Po ashtu kjo zyrë gjatë kësaj periudhe është përgjigjur në 170 kërkesa/pyetje me shkrim të parashtruara kryesisht nga media dhe OJQ. Janë publikuar 54 njoftime në rrjetin social Facebook, dhe 19 njoftime në ueb portalin gjyqësor.

Zyra për Informim e Gjykatës, në bashkëpunim me Programin e USAID për Drejtësi Komerciale, në fund të këtij viti ka organizuar dhe ceremoninë e shënimit të një vjetorit të funksionimit të Gjykatës Komerciale.

2.9. Përdorimi i mekanizmave për zgjidhjen alternative të kontesteve

Gjykata Komerciale gjatë muajit maj 2023, ka funksionalizuar zyrën për referimin e rasteve në procedurën alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, dhe ka caktuar referentin për trajtimin e këtyre rasteve.

Me funksionalizimin e kësaj zyre, përmes procedurës së Ndërmjetësimit, gjykata ka referuar tridhjetë (30) lëndë, prej tyre pesë (5) janë zgjidhur me marrëveshje ndërmjet palëve, trembëdhjetë (13) prej tyre kanë përfunduar pa marrëveshje dhe të njëjtat janë kthyer për trajtim në procedurë të rregullt gjyqësore, ndërsa dy (2) janë në procedurë.

2.10. Mbajtja e shqyrtimeve gjyqësore

Gjatë periudhës raportuese, Gjykata në kuadër të aktivitetit të rregullt, ka caktuar 1.585 sipas datave të caktuara dhe nuk janë evidentuar numër i madh i shtyrjeve ndërsa për seancat e shtyra arsytet kanë qenë kryesisht të ndërlidhura me palët ose me problemet administrative të dërgimit të ftesave për palët për shkak të joefikasitetit të PTK-së. Po ashtu nuk është evidentuar ndonjë problem lidhur me seancat e mbajtura.

III. Vendosja dhe fuqizimi i bashkëpunimeve gjatë vitit 2023

Këshilli Gjyqësor i Kosovës - KGJK dhe Programi i USAID për Drejtësi Komerciale në bazë të vendimit të KGJK-së Nr. 232/2023 të datës 12 qershor 2023, kanë lidhur Memorandumin e Bashkëpunimit për procesin e digjitalizimit të Gjykatës Komerciale.

IV. Raportimi financiar dhe logjistika

Sa i përket çështjeve logjistike, gjendja shfaqet e mirë në krahasim me periudhën paraprake.

Sa i përket çështjeve financiare në Gjykatën Komerciale kanë arritur gjithsejtë të procesohen për pagesë deri më 31.12.2023 , 36 fatura (të zotuar, të shpenzuara dhe të Certifikuara) në shumë prej 42,905.52 Euro.

Megjithatë ka shfaqur vështirësi mungesa e stafit në Zyrën për Buxhet dhe Financa dhe është dashur që të autorizojmë më punë shtesë zyrtarët e Gjykatës Themelore të Prishtinës për të kryer obligimet buxhetore.

Andaj, kërkohet që në afatin sa më të shkurtër të fillohet me procedurat e rekrutimit të zyrtarit të financave dhe logjistikës dhe vartësve të këtyre zyrave.

V. Përfundimi

Si përfundim vlerësoj se viti 2023, si viti i parë i plotë i funksionimit të Gjykatës Komerciale, të ketë rezultuar i suksesshëm në aspektin e ndarjes së detyrave dhe përgjegjësi të punës, si në aspektin teknik ashtu edhe në atë profesional. Bazuar edhe në planin vjetor të punës, gjyqtarët janë caktuar apo ri-caktuar në departamentet përkatëse, të gjitha lëndët janë regjistruar në regjistrat manual të gjykatës.

Efikasiteti i punës së Gjykatës Komerciale varet nga numri i rasteve që ajo ka në dorë, numri i gjyqtarëve dhe stafit tjetër që punon në gjykatë. Një gjykatë që ka një numër të madh të rasteve dhe një numër të vogël të gjyqtarëve, mund të ketë probleme në përmbushjen e detyrave dhe në arritjen e vendimeve në kohë. Kjo mund të çojë në ritme të ngadaltë të procesit gjyqësor, gjë që mund të ndikojë në besueshmërinë e publikut ndaj sistemit gjyqësor, përkatësisht Gjykatës Komerciale. Andaj është e nevojshme që të rrisim kapacitetet tona dhe në afatin sa më të shkurtër, të plotësojmë të gjitha pozitat e lira të përcaktuara edhe me organogramin e gjykatës,

Presim që në vitin 2024, pas aprovimit të Draft Strategjisë për Gjykatën Komerciale për vitin 2024 – 2025 dhe Planit të Veprimit për Reduktimin e Lëndëve, dhe me angazhimin e plotë të të gjithë gjyqtarëve në departamentet përkatëse, të shënohet rezultat pozitiv si në akseptin e zgjidhjes së numrit të lëndëve, ashtu edhe në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të Gjykatës Komerciale.

Megjithatë me krenari dëshmoj se Gjykata Komerciale është vazhdimisht duke punuar me përkushtim për të ofruar drejtësi të shpejtë për të gjitha palët, edhe përkundër sfidave me të cilat është ballafaquar gjykata, megjithatë ky është një tregues i një angazhimi të të gjithëve që të arrihet shkalla e spastrimit të lëndëve në masën e 96% për këtë periudhë të vitit 2023.

Mahir TUTULI

Kryetar i Gjykatës Komerciale

Raporti i Punës së Gjykatës Komerciale për vitin 2023 iu dorëzohet:

- Këshillit Gjyqësor të Kosovës,
- U.D Administratorit të Gjykatës Komerciale,
- Shefit të Zyrës për menaxhimin e lëndëve të Gjykatës Komerciale,
- Zyrës për Informim.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE
PRIVREDNI SUD - COMMERCIAL COURT